

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut 02-08.06.2025

Janë testuar gjithsej 140 materiale në Laboratorët ku bëhen analiza molekulare për vërtetimin e pranisë së virusit SARS-CoV-2, për një më pak se javën që shkoi. Janë regjistruar 3 raste pozitive, për 2 më shumë se javën e kaluar.

Tabela 1. Numri i testimeve dhe rasteve pozitive në periudhën nga 02-08.06.2025

Data	Testime	Pozitive	% e rasteve pozitive
02.6.2025	28	1	3,6%
03.6.2025	37	2	5,4%
04.6.2025	27	0	0,0%
05.6.2025	24	0	0,0%
06.6.2025	4	0	0,0%
07.6.2025	5	0	0,0%
08.6.2025	15	0	0,0%
Gjithsej	140	3	1,3%

Gjatë javës së kaluar (02-08.06.2025) është regjistruar 1 person i shëruar. Nuk janë raportuar raste të vdekjes si pasojë e COVID – 19.

GJENDJA ME COVID-19 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË VITIN 2025

Gjatë vitit 2025, deri më 08.06.2025 janë regjistruar gjithsej 49 raste me COVID-19. Në muajin maj të vitit 2025 numri i të sëmurëve (n=6) është për 33,3% më i madh se në muajin prill 2025 (n=9).

Gjatë vitit 2025 janë regjistruar 2 raste të vdekjes si pasojë e COVID-19.

Gjatë vitit 2025, deri më 08.06.2025, janë testuar gjithsej 5.631 materiale, në laboratorët në të cilët realizohen testime molekulare për prani të SARS-CoV-2 dhe në laboratorët / institucionet shëndetësore në të cilat bëhen testimet e shpejta antigjene.

Përqindja mesatare e pozitivitetit të mostrave të testuara për SARS-CoV-2 është 0,9%.

Vlerësimi i rrezikut

Gjatë periudhës së kaluar po regjistrohet vazhdimisht një përqindje e ulët e rasteve pozitive. Shkalla e ulët e transmetimit të SARS-CoV-2, rënia e numrit të raportimeve dhe testimeve ndikon në aftësinë për vlerësimin e gjendjes epidemiologjike. Variantet që qarkullojnë aktualisht nuk ka gjasa të shoqërohen me ndonjë rritje të ashpërsisë së infeksionit krahasuar me variantet që qarkullonin më parë ose një ulje të efektivitetit të vaksinës kundër sëmundjes së rëndë.

Popullata e EU/EEA në përgjithësi ka një nivel të konsiderueshëm të imunitetit hibrid (vaksinim/vaksinim me booster doza), që ofron një mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes. Personat mbi 60 vjet janë më të rrezikuar nga pasqyra e rëndë e sëmundjes.

Hospitalizimet e personave me COVID-19 të konfirmuar, pranimet në repartet e kujdesit intensiv dhe rastet e vdekjes mbeten në nivel të ulët në vendet e EU/EEA. Këto të dhëna nuk janë të disponueshme në R. e Maqedonisë së Veriut.

Edhe pse numri i rasteve me COVID-19 në nivel javor është i ulët, duke pasur parasysh se ndodhemi në një periudhë të një qarkullimi të rritur të viruseve respiratore në hemisferën veriore, nevojitet një mbikëqyrje e vazhdueshme (epidemiologjike dhe virusologjike) në rrafsh lokal dhe kombëtar.

Masa të rekomanduara për parandalim dhe kontroll

Rekomandohet ndjekja e masave themelore për parandalimin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera respiratore.

Vaksinimi mbetet si masë specifike që mundëson mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes, edhe pse ky efekt mbrojtës me kalimin e kohës dobësohet. Mbetet rekomandimi për vaksinimin e personave me rrezik të lartë nga format e rënda të sëmundjes (siç janë personat më të moshuar).¹

Shkup, 09.06.2025

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse

Instituti i Shëndetit Publik

¹ <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/2024-WCP-0039%20Final.pdf>